



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KORÇË

Numri i Çështjes	53504-00233-41-2008	Data e Regjistrimit	9/9/2008
Numri i Vendimit	41-2008-3047	Data e Vendimit	11/18/2008

VENDIM
NE EMER TE REPUBLIKËS

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KORÇË E PERBERE NGA:

KRYESUES: Admir Belishta

ANËTAR

SEKRETARE Artan Frasheri

Objekti: KONTRABANDE ME MALLRA TE TJERA
FALLSIFIKIM DOKUMENTA

Baza Ligjore : NENI 174,186/1 E 190/1 E KODIT PENAL

Përmbledhja e vendimit:

Ne perfundim te gjykimit, gjykata pasi degjoi pretendimet perfundimtare te organit te Prokurorise prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Korce, perfaqesuar nga prokurori Edmond Shytko, i cili kerkoi: Deklarimin fajtor te te pandehurit Ylli Shehu, per vepren penale te kontrabandes me mallra te tjera dhe ne baze te nenit 174 te K.Penal denimin e tij me 200.000 leke gjobe; Deklarimin fajtor te te pandehurit Ylli Shehu per vepren penale te fallsifikimit te dokumentave dhe ne baze te nenit 186/1 te K.Penal denimin e tij me 200.000 leke gjobe; Deklarimin fajtor te te pandehurit Ylli Shehu per vepren penale te fallsifikimit te vulave, stampave ose formulareve dhe ne baze te nenit 190/1 te K.Penal denimin e tij me 200.000 leke gjobe; Ne bashkim te denimeve bazuar ne nenin 55 te K.Penal denimin e te pandehurit Ylli Shehu me 600.000 leke gjobe; shpenzimet proceduriale ne vleren 70.000 leke t'i ngarkohen te pandehurit; pasi degjoi pretendimet e mbrojtetit te te pandehurit Ylli Shehu, Av.Robert Hyska i cili kerkoi denimin e ketij te pandehuri me gjobe ne kufijte minimale te parashikuara ne ligj si dhe mundesine e shlyerjes me keste, pasi degjoi te pandehurin Ylli Shehu, i cili kerkoi meshire, shqyrtoi provat e paraqitura ne seance gjyqesore, si dhe pasi analizoi ne teresi ceshtjen

Ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Korce është regjistruar për gjykim në dt.09.09.2008 çështja penale me Nr.Regj.Themeltar 53504-00233-41-2008 (386), në ngarkim të te pandehurit Ylli Shehu, i akuzuar për veprat penale të kontrabandes me mallra të tjera, të fallsifikimit të dokumentave dhe të fallsifikimit të vulave, stampave ose formulareve, parashikuar nga nenet 174, 186/1 dhe 190/1 të K.Penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Korce konstatoi kryesisht, që në fillim të gjykimit, faktin se shqyrtimi i saj i përket juridiksionit gjyqesor penal bazuar në nenin 69 të K.Pr.Penale. Kjo gjykate është kompetente si nga pikepamja lëndore ashtu dhe ajo tokësore për shqyrtimin e kesaj çështje bazuar në nenet 74 dhe 76/1 të K.Pr.Penale.

Ne shpjegimet e tij rreth fakteve objekt akuze të dhena para gjykates, perfaqesuesi i organit te prokurorise, prokurori Edmond Shytko, pohoi se:

Ne muajt tetor – nentor 2003 shtetasi Ylli Shehu kishte futur në Shqipëri automjetin autoveture BMW X5 pa paguar detyrimin e sakte doganor. Ky shtetas mjetin e tij BMW X5



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KORÇË

me Nr.shasie WBFA71050LN18681 kishte dashur ta targonte duke iu shmangur detyrimit doganor dhe per kete ai kishte paraqitur ne Degen e Doganes Korce dokumenta zhdoganimit te cilat nuk paraqesnin realitetin, pasi pasqyronin nje mjet BMW AG, me vit prodhimi 1989, dhe jo mjetin real BMW X5, prodhim te vitit 2001. Nepermjet ketij veprimi shtetasi Ylli Shehu kishte mundur te shmangej nga detyrimi doganor ne <?xml:namespace prefix = st1 ns = "urn:schemas-microsoft-com:office:smarrtags" />shumen 1.119.109 leke duke paguar vetem shumen prej 154.421 leke. Dokumentat e paraqitura kishin bere te mundur qe ky shtetas te merrte deklaraten doganore dhe me pas kete deklarate ta ndryshonte ne permbajtje, ne vula, shkrime e nenshkrime te doganes Korce. Me pas kete deklarate se bashku me dokumenta te tjera te mjetit tashme real X5 i kishte dorezuar ne Drejtorine Rajonale te Transportit Rrugor Tirane duke bere dhe targimin e ketij mjeti me targen TR 3434 J. Me vone, e konkretisht ne dt.11.02.2004, kete automjet ia kishte shitur shtetasit Albert Shulku me banim ne Tirane, i cili aktualisht e disponon kete mjet.

Ne keto kushte ne dt.13.05.2008 Prokuroria prane Gjykeses se Rrethit Gjyqesor Korce kishte regjistruar procedimin penal Nr.477 ne ngarkim te shtetasit Ylli Shehu, si person i dyshuar per konsumimin e veprave penale te kontrabandes me mallra te tjera, te fallsifikimit te dokumentave dhe te fallsifikimit te vulave, stampave ose formulareve, parashikuar perkatesisht nga nenet 174, 186/1 dhe 190/1 te K.Penal. Pas perfundimit te hetimeve mbrojtetit te caktuar kryesisht Av.Robert Hyska, i ishte komunikuar nga organi i prokurorise akuzat per te cilat shtetasi Ylli Shehu dyshohej fillimisht, duke marre ne kete menyre cilesine procedurale te te pandehurit, si dhe ishte depozituar ne gjykate kerkesa per gjykimin e kesaj ceshtje.

Per te provuar akuzen organi i prokurorise paraqiti me cilesine e provave shkresore ne kete gjykim dosjen e mjetit me targe TR 3434 J se bashku me materialin kallzues te Drejtorise se Pergjithshme te Doganave dhe dosjen e deges se Doganes Korce; procesverbalin mbi zbatimin e sekuestros dt.05.06.2008; kontraten e shitjes dt.11.02.2004 me shites Ylli Shehu dhe bleres Albert Shulku; mandat pagese dogane dt.04.11.2003; deklaraten e bere nga Ylli Shehu dt.04.11.2003 ne Drejtorine Rajonale te Sherbimit dhe Transportit Rrugor Tirane; deklaraten doganore dt.04.11.2003; dokumentin e hyrjes ne Piken e Kalimit Kufitar Durres dt.28.10.2003; vertetimin e zhdoganimit dt.04.11.2003; certifikaten e kontrollit teknik dt.03.11.2003; vertetimin e banimit te Ylli Shehut; certifikaten e lindjes me fotografi te Ylli Shehut dt.30.10.2003; vertetimin e hyrjes dt.28.10.2003 te Doganes Durres; kerkesen deklarate te Albert Shulkut dt.12.02.2004 ne Drejtorine Rajonale te Sherbimit dhe Transportit Rrugor Tirane; lejen e qarkullimit te Ylli Shehut dt.04.11.2003; certifikaten e kontrollit teknik bere ne Drejtorine Rajonale te Sherbimit dhe Transportit Rrugor Tirane nga Albert Shulku; vertetimin e banimit te Albert Shulkut dt.10.02.2004; certifikaten e lindjes me fotografi te Albert Shulkut dt.09.02.2004; mandatin e arketimit me fature sherbimi per Albert Shulkun dt.12.02.2004; rregjistrimin e mjetit TR 3434 J ne emer te Ylli Shehut dt.04.11.2003 dhe kalimi ne emer te Albert Shulkut dt.11.02.2004; librezen e mjetit, deklaraten e shitjes, certifikaten e pronesis se mjetit (me perkthim); rregjistrimin e mjetit ne emer te Ylli Shehut dt.11.11.2003; rregjistrimin e mjetit ne emer te Albert Shulkut; mandatin e arketimit ne emer te Ylli Shehut dt.04.11.2003; procesverbalin per zbatimin e sekuestros dt.27.06.2008; mandatin dt.04.11.2003 te Tirana Bank dega Korce; deklaraten doganore dt.04.11.2003 te Doganes Korce; vertetimin e zhdoganimit dt.04.11.2003 te Doganes Korce; vertetimin e hyrjes dt.28.10.2003 te Doganes Durres; deklarate shitje; certifikaten e pronesis dhe librezen e qarkullimit (me perkthim); shkresat Nr.3732/6 dt.01.07.2008, Nr.6809/1 dt.25.07.2008, Nr.3068/1 dt.20.06.2008; formular kerkimi Nr.1237 dt.09.06.2008; aktin e ekspertimit vleresues dt.07.07.2008; aktin e ekspertimit teknik te numrit te shasise per mjetin me targe TR 3434 J, Nr.161 dt.21.07.2008; aktin e ekspertimit teknik grafik Nr.171 dt.04.08.2008; certifikaten e lindjes dhe deshmine e penalitetit dt.20.06.2008, te Ylli Shehut; si dhe kerkoi thirrjen e deshmitareve Andon Pasholli, Fredi Blushi, Jace Hysolli dhe Albert Shulku.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KORÇË

Ne seancen gjyqesore te dt.14.11.2008 bazuar ne kerkesen e prokurorit te ceshtjes, gjykata revokoi vendimin e saj te marre ne seancen e kaluar per pyetjen e deshmitareve Andon Pasholli, Fredi Blushi, Jace Hysolli dhe Albert Shulku.

Ne shpjegimet e tij mbrojtesi i te pandehurit Ylli Shehu, Av.Robert Hyska, pohoi faktin se i pandehuri qe ai mbronte i pranonte akuzat dhe se ndjehej i penduar. Gjithashtu ky mbrojtes i kerkoi gjykates te kishte parasysh momentin ne te cilin ishin kryer veprat penale dhe koha ne te cilen ky shtetas eshte marre i pandehur, pasi ishim ne kufijte e parashkrimit te ndjekjes penale qe parashikon neni 66 i K.Penal, c'ka do te thote se ishte zbehur se tepermi rrezikshmeria shoqerore e veprave penale per te cilat akuzohet i pandehuri, personalitetin e te pandehurit, faktin se i pandehuri ishte pa ndonje precedent penal, ishte ne kushte te veshtira ekonomike e familjare, ishte i martuar me nje femije te mitur, si dhe faktin qe ishte i papune dhe te ardhurat per jetese ishin vetem ato te dy pleqve te moshuar. Duke marre ne konsiderate te gjitha keto elemente, ky mbrojtes i kerkoi gjykates qe te jepte nje denim me gjobe ne kufijte minimale te parashikuara ne ligj.

Gjykata na analizen e saj cmon se nepermjet provave te administruara ne gjykim, u provua katerciperisht se i pandehuri Ylli Shehu ka konsumuar elementet e tre veprave penale per te cilat ai akuzohet. Permbajtja e vete provave te cilat jane ne unitet me njera tjetren provoi jo vetem ekzistencen e veprave penale por dhe autoresine e saj, qe eshte i pandehuri Ylli Shehu, te cilen e pranon dhe vete i pandehuri. Ne keto kushte gjykata konstaton faktin se i pandehuri Ylli Shehu ka konsumuar plotesisht elementet e veprave penale te kontrabandes me mallra te tjera, te fallsifikimit te dokumentave dhe te fallsifikimit te vulave, stampave ose formulareve, parashikuar nga nenet 174, 186/1 dhe 190/1 te K.Penal.

Ne rastin konkret, persa i perket vepres penale te kontrabandes me mallra te tjera jane **cenuar maredheniet juridike te vendosura per importimin, eksportimin apo tranzitimin e mallrave te zakonshme duke cenuar interesat shteterore nga mosnxjerrja e taksave doganore**, te mbrojtura posacerisht me legjislacionin penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale.

Nga ana objektive ky krim eshte kryer **me veprime aktive te kundraligjshme, me ane te eksportimit nga nje shtet i huaj ne shtetin shqiptar te mallrave te zakonshme (konkretisht te nje makine te tipit BMW X5), duke e kaluar (fatur) ne kundershtim me rregullat e shtetit shqiptar, me qellim shmangien nga detyrimet doganore.**

I pandehuri Ylli Shehu eshte subjekt i pergjithshem i vepres penale. Ai ka mbushur moshen per pergjegjesi penale dhe se ndaj tij nuk ekziston asnje shkak padenueshmerie. **Ne keto kushte ai eshte plotesisht te pergjegjshem para ligjit penal shqiptar.**

Nga ana subjektive kryerja e kesaj vepre penale eshte kryer nga i pandehuri **me dashje direkte si forme fajesie dhe me qellimin e posacem te shmangies nga detyrimet doganore te cilat i sjellin perfitime materiale.**

Gjithashtu i pandehuri Ylli Shehu ka konsumuar plotesisht elementet e veprave penale te fallsifikimit te dokumentave, parashikuar nga neni 186/1 i K.Penal, si dhe ate te fallsifikimit te vulave, stampave ose formulareve, parashikuar nga neni 190/1 i K.Penal.

Ne rastin konkret veprimet e te pandehurit Ylli Shehu ne lidhje me keto 2 vepra penale kane cenuar maredheniet juridike te vendosura ne vendin tone te cilat sigurojne, **veprimtarine e rregullt te aparatit shteteror, te mbrojtura posacerisht me legjislacionin penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale. Objekt material ne rastin objekt gjykimi jane nje sere dokumentash fiktive ne nenshkrimet e tyre dhe ne elementet e permbajtjes, si dhe nje sere dokumentash te tjera, te cilat pasqyrojne si element fiktiv te tyre vulat e**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KORÇË

institucioneve shtetërore.

Nga ana objektive keto vepra penale janë kryer me veprime aktive kriminale. **I pandehuri Ylli Shehu ne kundershtim me ligjin, ka paraqitur para organeve shtetërore dokumenta te fallsifikuara ne nenshkrimet e tyre**, persa i perket identitetit te te pandehurit, nenshkrimit te te pandehurit, si dhe elemente te tjere te permbajtjes se ketyre dokumentave. Po keshutu ky i pandehur ka paraqitur para organeve shtetërore edhe vula fiktive te disa dokumentave. Si te tilla permendim deklaraten doganore Nr.3043 dt.04.11.2003, deklaraten e shitjes, certifikaten e pronesise italiane, librezen italiane te qarkullimit te automjetit, vertetimin e hyrjes Nr.0013238 dt.28.10.2003, si dhe dokumentin e hyrjes nga policia.

I pandehuri Ylli Shehu eshte subjekt i pergjithshem i vepres penale. Ai ka mbushur moshen per pergjegjesi penale dhe se ndaj tij nuk ekziston asnje shkak padenueshmerie. **Ne keto kushte ai eshte plotesisht i pergjegjshem para ligjit penal shqiptar.**

Nga ana subjektive konsumimi i ketyre veprave penale eshte kryer **me dashje direkte si forme fajesie. I pandehuri edhe pse e dinte se po perdorte ne menyre te kundraligjshme dokumenta te fallsifikuara, si dhe vula fiktive, ai perseri i kishte perdorur prane organeve shtetërore shqiptare. Konsumimi i ketyre veprimeve eshte bere nga qellimi i posacem i perfitimit material.**

Ne keto kushte gjykata konkludon se akuzat e ngritura nga Prokuroria prane Gjykeses se Rrethit Gjyqësor Korçe ndaj te pandehurit Ylli Shehu, janë te provuara. I pandehuri Ylli Shehu duhet te deklarohet fajtor per kryerjen e veprave penale te kontrabandes me mallra te tjera, parashikuar nga neni 174 i K.Penal, te fallsifikimit te dokumentave, parashikuar nga neni 186/1 i K.Penal dhe ate te fallsifikimit te vulave, stampave ose formulareve, parashikuar nga neni 190/1 i K.Penal. (ligji i kohes se konsumimit te kesaj vepre penale para ndryshimeve te bera ne vitin 2004 qe eshte njekohesisht dhe ligji penal favorizues).

Ne caktimin e llojit dhe mases se denimit kjo gjykate ka pasur parasysh rrezikshmerine shoqerore te veprave penale, te autorit te saj, rendesine e faktit (kohen e kryerjes se tyre qe shkon rreth 5 vjet), rrethanat e kryerjes se vepres penale, si dhe rrethanat lehtesuese dhe renduese qe jane per kete te pandehur. Si te tilla rrethana mund te permendim pranimin e akuzave dhe pendimin e tij te treguar ne gjykim, gjendjen familjare, moshen e tij, gjendjen gjyqësore e cila eshte e bardhe, pa ndonje precedent penal (fakt i provuar nga deshmia e penaltetit dt.20.06.2008). Po keshtu gjykata ka pasur gjithashtu parasysh dhe marzhet e denimit qe parashikon ligji i kohes kur jane konsumuar veprat penale qe eshte dhe ligji favorizues, i cili parashikon nje denim me gjobe ose burgim deri ne 3 vjet, per vepren penale parashikuar nga neni 186/1 i K.Penal dhe gjobe ose burgim deri ne 5 vjet, per veprat penale te parashikuara nga nenet 174 dhe 190/1 te K.Penal.

Ne kete kendveshtrim, gjykata duke pasur parasysh faktin e llojeve te denimit qe parashikojne veprat penale te kontrabandes me mallra te tjera, ajo e fallsifikimit te dokumentave, si dhe e fallsifikimit te vulave, stampave ose formulareve, marzhin e denimeve si dhe perhapjen e tyre ne shoqerine shqiptare cmon se lloji i denimit me gjobe te kerkuar nga organi i prokurorise, eshte mese i pershtatshem per rastin konkret dhe se i pergjigjen kushteve dhe rrethanave te ketij rasti. Po keshtu duke analizuar te gjithë elementet e sipercituara, gjykata cmon se masa e denimit prej 200.000 leke gjobe, per secilen veper, eshte eshte nje mese qe i pershtatet te gjitha rrethanave te rastit konkret.

Nga ana tjeter gjykata cmon se pretendimi i mbrojtetit te te pandehurit per nje mese denimi me gjobe ne kufijte minimale te parashikuara ne ligj eshte i pabazuar ne prova dhe i



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KORÇË

pajustificuar ligjerisht. Si i tille ky pretendim nuk mund te pranohet nga gjykata.

Ne keto rrethana i pandehuri Ylli Shehu duhet te deklarohet fajtor dhe te denohet per kryerjen e veprave penale te kontrabandes me mallra te tjera, parashikuar nga neni 174 i K.Penal, ate te fallsifikimit te dokumentave, parashikuar nga neni 186/1 i K.Penal si dhe ate te fallsifikimit te vulave, stampave ose formulareve, me gjobe si lloj denimi. Ne lidhje me masen e denimit gjykata cmon se ky i pandehur duhet denuar per secilen veper me nga 200.000 leke gjobe. Ne bashkim te denimeve, ne aplikim te nenit 55 te K.Penal, duke aplikuar sistemin e ashpersimit per shkak te faktit qe veprat penale jane konsumuar me qellim perfitimin material, ky i pandehur duhet te denohet per te tre veprat penale me nje denim te vetem prej 600.000 (gjashteqindmije) leke gjobe. Ky lloj dhe mase denimi, i sherben ndeshkimit, rehabilitimit dhe parandalimit te ketij te pandehuri per kryerjen e kesaj vepre penale si dhe per vepra te tjera penale. Gjykata cmon gjithashtu se nje denim i tille i sherben jo vetem qellimit te ligjvenesit i aplikuar ne rastin konkret, por njekohesisht dhe dhenies se nje vendimi te drejte, objektiv dhe sa me afer se vertetes. Bazuar ne nenat 34/6 dhe 34/7 te K.Penal, gjykata cmon se pagimi i gjobes duhet bere me dy keste me nga 300.000 (treqindmije) leke secili, brenda 1 (nje) viti nga dita qe vendimi te marre forme te prere.

Ne dhenien e ketij vendimi gjykata bazuar ne ne nenin 393/1 te K.Pr.Penale detyron te pandehurin per pagimin e shpenzimeve proceduriale ne vleren 70.000 (shtatedhjetemije) leke.

Për keto arsye:

Gjykata bazuar ne nenet 379-386 dhe 390 te K.Pr.Penale

1. Deklarimin fajtor te te pandehurit Ylli Shehu per vepren penale te kontrabandes me mallra te tjera, dhe ne baze te nenit 174 te K.Penal denimin e tij me 200.000 (dyqindmije) leke gjobe.
 2. Deklarimin fajtor te te pandehurit Ylli Shehu per vepren penale te fallsifikimit te dokumentave, dhe ne baze te nenit 186/1 te K.Penal denimin e tij me 200.000 (dyqindmije) leke gjobe.
 3. Deklarimin fajtor te te pandehurit Ylli Shehu per vepren penale te fallsifikimit te vulave, stampave ose formulareve, dhe ne baze te nenit 190/1 te K.Penal denimin e tij me 200.000 (dyqindmije) leke gjobe.
- Ne bashkim te denimeve, bazuar ne nenin 55 te K.Penal ky i pandehur te denohet perfundimisht me 600.000 (gjashteqindmije) leke gjobe, e cila duhet paguar me 2 (dy) keste me nga 300.000 (treqindmije) leke secili kest, brenda 1 (nje) viti nga dita qe vendimi te marre forme te prere.
1. Shpenzimet proceduriale ne vleren 70.000 (shtatedhjetemije) leke i ngarkohen te pandehurit Ylli Shehu.
 2. Kunder vendimit lejohet te behet ankim ne Gjykatën e Apelit Korçe brenda 10 diteve duke filluar nga e nesermja e shpalljes.

U shpall ne Korçe sot me dt.18.11.2008 ora 12.30



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KORÇË

Ky dokument është marrë nga www.gjkata.gov.al. Ai ka vlerë të plotë informuese, por nuk shërben si dokument zyrtar. Ky i fundit lëshohet nga autoritetet përkatëse.

[shqiptarja.com]